POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1
Olta Gixhari gjen 'viktimën' e radhës: Vetëm unë mundem të të përzë nga Big Brother

2
Krijohet çifti në Big Brother VIP, vjen puthja e shumëpritur (Foto)

3 
E trishtë në Lushnjë/ Infermierja ndahet nga jeta në moshën 29 vjeçare

4
The Sun: Bandat shqiptare sundojnë trafikun e kokainës në Britani, por janë paralajmëruar që të mos hyjnë në këtë qytet

5 
Dea Mishel me thikë në dorë drejtuar Luizit? Video-ja që po bën xhiron e rrjetit

Kronikë

VIDEO/ Shpërthim tritoli në banesën e shefit të krimeve në Shkodër, dëmtohen muret edhe automjetet! Pllumb Shpati: S'kam konflikt me askënd

Një sasi tritoli ka shpërthyer pak para se të zbardhej në banesën e shefit të krimeve të Komisariatit në Shkodër, Pëllumb Shpati. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 03:50 në lagjen Dobraç, ku si pasojë janë dëmtuar muret e banesës së tij por edhe automjeti i 49-vjeçarit. Pllumbi jetonte së bashku me dy vëllezërit e tij në të njëjtën banesë, ishin në total 17 anëtarë

■ Shpërthimi i fuqishëm me tritol shefit të krimeve në Shkodër, i ati: Ka dëme kudo, ka ardhur për shkak të detyrës se s'kemi ngatërresa

■ Shpërthim tritoli në shtëpinë e shefit të krimeve në Shkodër, del VIDEO nga dëmet në banesë dhe në automjet

[Sh].com **Redaksia**
13 Janar, 08:11 | **Përditesimi: 13 Janar, 15:32**

SHKODËR- Familja Shpati është zgjuar në orët e para të mëngjesit të sotëm nga një shpërthim i fuqishëm në banesën e tyre. Një sasi lënde eksploziv është vendosur në banesën e Pllumb Shpatit, shef i krimeve në Komisariatin e Shkodrës rreth orës 03:50 në lagjen Dobraç, në periferi të Shkodrës, duke shkaktuar dëme të shumta materiale në dyer, mure, dritare si dhe në automjete.

Pllumb Shpati jetonte në një vile 3-katëshe së bashku me familjet e 2 vëllezërve të tij. Në total në familje janë 17 anëtarë. I pari që u prononcua për mediat ishte Gjergj Shpati, i ati i shefit të krimeve në policinë e Shkodrës.

[Sh].com



LEXO EDHE:
Goditje e madhe në merkato, drejtori i Vllaznisë: Jemi në bisedime me Bekim Balaj

Babai u shpreh se familja e tij nuk ka asnjë konflikt dhe se sulmi ka ardhur për shkak të detyrës. I moshuari u shpreh gjithashtu se dëmet materiale janë të shumta dhe se shpërthimi ishte shumë i fuqishëm. Ai kërkoi nga shteti të vijonte me hetimet.

Gazetari i Report Tv, Ergys Kavaja raportoi se në dëshminë e 49-vjeçarit Pllumb Shpati nuk ishte dhënë asnjë detaj konkret, pasi ky i fundit nuk kishte asnjë dyshim se nga kush mund t'i kishte ardhur sulmi.

Sidoqoftë, për blutë e Shkodrës ka një shans për identifikimin e autorit falë disa kamerave të sigurisë në hyrje të lagjes Dobraç.

[Shqiptarja.com]
POLICIA

Pllumb Shpati

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 11:35

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton

Tritol banesës së shefit të krimeve në Shkodër, kamerat kapën momentin kur një person vendosi lëndën plasëse

Kamerat e sigurisë kanë filmuar autorin që iu afrua banesës së shefit të krimeve, Pllumb Shpati për të vendosur sasinë e tritolit. Ngjarja ndodhi rreth orës 03:50 në lagjen Dobraç.

Ora 10:24

Shpërthimi me tritol në banesën e shefit të krimeve në Policinë e Shkodrës, Pllumb Shpati jashtë kamerave: S'kam konflikt me askënd

Shefi i Krimeve të Policinë e Shkodrës, Pllumb Shpati ka folur jashtë kamerave për sulmin me tritol në banesën e tij. Ai është shprehur se nuk ka konflikt me askënd dhe se nuk ka dijeni se kush mund ta ketë bërë sulmin ndaj tij.

Ora 08:54

Shpërthimi i fuqishëm me tritol shefit të krimeve në Shkodër, i ati: Ka dëme kudo, ka ardhur për shkak të detyrës se s'kemi ngatërresa

Për shkak të detyrës e ka cilësuar i ati i shefit të krimeve në Shkodër, Pllumb Shpatit motivin e shpërthimit në banesën e tij pak para se të zbardhej. Gjergj Shpati në një prononcim për mediat shprehet se dëmet janë kudo në dyer, driatare e fasadë. Në banesën e Pllumb Shpatit jetonin 3 familje, 17 anëtarë. Babai i tij thotë se nuk kanë asnjë konflikt dhe se së fundmi djali i tij nuk ka patur asnjë kërcënim.

> *"Kam dalë dhe kam dëgjuar krismën kam dalë dhe e kam parë. Ne jetojmë këtu 3 familje, ishte i fuqishëm, të kallxojnë vetë shikoni dëmet. Ka dëme në dritare, dyer, fasadë…*
>
> *Se dimë nga erdhi, se priti kush.*
>
> *Nuk e dimë, ishim në gjumë. Po për shkak të detyrës së ne s'kemi ngatërresa, si kam kujt borxh as më ka."- tha Gjergj Shpati.*

Pyetje: Cila është kërkesa juaj?

Gjergj Shpati: Shteti me pas mundësi të bëjë punën e vetë, të hetojë.

Ora 08:40

Shpërthim tritoli në shtëpinë e shefit të krimeve në Shkodër, del VIDEO

nga dëmet në banesë dhe në automjet

Pamjet që shihni janë dëmet që ka shkaktuar shpërthimi me tritol në banesën e shefit të krimeve në Komisariatin e Shkodrës, Pllumb Shpati. Ngjarja ndodhi në Dobraç rreth orës 03:50.

Ora 08:17

FOTO/ Ja kush është shefi i Krimeve të komisariatit Shkodër që iu vu tritol para banesës

[Shqiptarja.com]

Ky është Pllumb Shpati, 49 vjeç, shefi i Seksionit për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Shkodër të cilit iu vendos tritol para banesës së tij në lagjen Dobraç. Ngjarja ndodhi në orën 03:50.

G.MO/SI.E./Shqiptarja.com

TAG: pllumb shpati tritol Shkoder

Komento

Komente

iliri: 13/01/2023 18:52

me mire te iki ne amerike sesa te rrije ketu e te lere kockat per kete shtet bandit....

Përgjigju

Doshi Gjoka: 13/01/2023 16:17

Ka ken i lidhun me krimin nuk bahesh shef krimesh ne Shkoder, dicka qe dim te tane. Kjo asht lufte mes klanesh se rilindjes

Përgjigju

Na ishte njehere: 13/01/2023 13:54

Po frederik rragamin ku e kena ?

Përgjigju

Gon suma: 13/01/2023 15:00

E ka federik.

Miri: 13/01/2023 12:11

E gezofsh azilin vlla e tu prifte mbare ne usa

Përgjigju

Ben: 13/01/2023 11:48

kta te gjith keshtu thon thua se jan super te ndershem dhe per shkak te detyres i sulmojn.kta jan ca hajdut dhe vemje qe se kan shokun

Përgjigju

Koleci: 13/01/2023 11:43

O Cuni!shteti nuk bashkpunon me bandat! Por banditet me uniform (jo te gjth) dashkpunojne me bandat.

Përgjigju

leo: 13/01/2023 11:30

Kjo eshte kultura shkodrane.....!!!

Përgjigju

cuni: 13/01/2023 11:07

perdite kemi raste qe na tregojne se shteti ba shkepunon me bandat...

Përgjigju

Shkoder: 13/01/2023 09:44

Ma burr te keq se ban nana , shifni dhe ftyren se e tregon vet . Mjer policia buk kuptohen a jan polic a jan bandita

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH com

Sondazhi i ditës:
Alibeaj apo Salianji, kush duhet ta drejtojë grupin e PD?

Alibeaj | Salianji | Nuk e di

Lajme të tjera

Iku nga Partia e Lirisë, reagon për herë të parë Agron Çela: T'i japim shansin PS-së të drejtojë bashkinë e Shkodrës pas 30 vitesh

13 Janar, 10:14

Iu gjetën disa doza kokainë brenda një lokali në Shkodër, arrestohet i riu, nën hetim pronari

12 Janar, 14:03

Në kërkim për organizim të lojërave të fatit, kapet dhe vihet në pranga 26-vjeçari në Malësinë e Madhe

12 Janar, 13:05

Dëshmia e ish-kryebashkiakut të Shkodrës: Më 14 janar '90 në qendër të qytetit, te busti i Stalinit që ishte mbush me njerëzit e Sigurimit...

Filip Guraziu

12 Janar, 07:20

Braktisi automjetin me drogën brenda dhe u arratis në errësirë, arrestohet 22-vjeçari në Shkodër! I sekuestrohet edhe një pistoletë

11 Janar, 10:03

Zaloshnja: A do të jetë rezultati në Bashkinë Shkodër një shumatore e thjeshtë aritmetike?

Eduard Zaloshnja

10 Janar, 12:24

Njëri kishte armë me vete, tjetri lëndë narkotike në makinë, arrestohet 22-vjeçari në Shkodër, në kërkim bashkëmoshatari tjetër

10 Janar, 11:00

Moti i keq në Shkodër, rrëshqitje dherash në Postribë, bllokohet aksi Mes-Ura e Shtrenjtë

10 Janar, 09:24

Ngjarja makabre e gushtit '89, Filip Guraziu: Pasi kufitarët i sharruan me plumba Gjonin e Dodën, kufomat e tyre, gjysmë lakuriq, i shëtitën nëpër rrugët e Shkodrës

Filip Guraziu

10 Janar, 07:33

Hodhi foshnjën e saj 6-ditëshe në lumin Kir, lihet në burg nga Gjykata e Shkodrës 32-vjeçarja

9 Janar, 11:00

Dëshmia e rrallë e ish-kryebashkiakut të Shkodrës: Sipas 'Revolucionit Kulturor' kinez, ne arsimtarëve, na çuan në aksion në fshatin Guri i Zi

Filip Guraziu

8 Janar, 07:22

Spiropali valle me Agron Çelën, i thurin lavde: O bukuria Elisa mos t'u prishtë, sa e bukur paske kenë (VIDEO)

7 Janar, 12:15

Kodi Etik Kontakt Rreth Nesh Raportoni Ju

[Shqiptarja.com]

Kerko

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje